



BASHKIA ROSKOVEC

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT MJEDISIT
DHE PRONËS**

**OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I BANESAVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË
PËR VITIN : 2026-2027**

RELACION TEKNIK

Miratohet :
Kryetari i Bashkisë
Majlinda Buri



Relacion përmbledhës

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Roskovec, ka evidentuar problematika dhe hartuar projekte teknike për familje në nevojë, të cilat banojnë në kushte jo të mira, brenda territorit të Bashkisë Roskovec.

Janë evidentuar **5 banesa**, të cilat kanë nevojë emergjente për ndërhyrje, shumica e të cilave janë të pambrojtura ndaj agjentëve atmosferike, dhe kanë probleme serioze si pasojë e amortizimit të catisë, mungesës së dyerve dhe shtresave të dyshemesë. Teknikisht disa prej tyre janë të pabanueshme, duke i detyruar banorët të jetojnë në kushte ekstreme.

Ndërkohë shumica e familjeve kanë në përbërje të moshuar dhe fëmijë, të cilët i përballojnë këto kushte me shumë vështirësi. Familjet përfituese janë pronarë të truallit ku banojnë.

Pamundësia për mirëmbajtje të vazhdueshme i ka kthyer disa nga banesat në kërcënim për jetesën. Ekziston një pjesë e mirë e tyre, të cilat edhe pse janë ndërtim i ri, shumë shpejt do të amortizohen pasi janë ndërtuar pa kriteret dhe nuk kanë respektuar normat minimale të ndërtimit, gjithashtu një pjesë tjetër kanë rinisur për ti bërë ato por në pamundësi financiare kanë ndaluar punimet për vite me radhë duke qëndruar në banesa jo të përshtatshme për një jetesë normale. Disa prej banesave janë në fazën e karabinasë, të ndërtuara si muraturë, por ku dritaret dhe dyert janë mbyllur me materiale rrethimore dhe jetohet në kushte ekstreme. Disa nga familjet përveç se jetojnë në kushte jo të mira por edhe në sipërfaqe të vogla për numrin e antarëve që kanë, ku është menduar për të bërë shtesa në banesë.

Në të gjithë objektet me soletë betoni mungon hidroizolimi dhe reshjet atmosferike i kanë degraduar më tej duke krijuar lagështirë në brendësi.

Ky fond do të shërbejë jo vetëm për përmirësimin e kushteve të banesave, por dhe si program për edukimin e komunitetit rreth mënyrave të mirëmbajtjes së tyre, pas realizimit të investimit.

Gjatë zbatimit të projektit është menduar të angazhohen pjesëtarët e komunitetit në realizimin e punimeve, duke shërbyer si një instrument për përvetësimin e teknikave dhe menyrave të rregullimit dhe mirëmbajtjes së banesave.

Kjo mënyrë është pare si një zgjidhje, që ky komunitet të edukohet me konceptin e punës dhe të kontribuojnë i kujdesin ndaj banesave të tyre.

Duke parë dhe numrin e madh të pjestarëve për çdo familje, mesatarisht me 4-5 anëtarë, dhe ku shumica e tyre kanë probleme shëndetësore, janë të papunë, kanë pjestar me aftësi ndryshe apo janë përfitues të ndihmës ekonomike, ky fond do të ndihmojë në rritjen e mirëqenies së familjes.

Një cati e dëmtuar e ka të siguruar shumicën e materialit, por kërkon sistemim, për të mos u degraduar më tej.

Mbulesat, ku përfshihen çatitë dhe tarracat janë elementet kryesore në zërat e punimeve për rikostruksionin. Mbulesa është elementi kryesor i mbrojtjes ndaj agentëve atmosferikë dhe në shumicën e banesave ky element e ka humbur funksionin bazik. Gjatë rikonstruksionit do të merret në konsideratë:

- përdorimi sa më shumë i materialeve ekzistuese të banesave -përforcimi i strukturës së çative me konstruksion druri

- zëvendësimi i tjegullave të dëmtuara

- plotësimi i tyre në pjesët munguese

- disiplinimi i ujrave të shiut nëpërmjet vendosjes së ullukëve

- riparimi i tavanit të shtëpive ku në shumicën e rasteve ka rënë

- suvatime të muraturës së brendshme dhe të jashtme

- riparimi i dyshemeve dhe bazamentit të shtëpise

- restaurimi i ambjenteve të brendshme .

- forcimi i muraturave ku është e nevojshme

- zëvendësimi i dyerve.

Zëvendësimi dhe plotësimi i dyerve është një tjetër ndërhyrje e rëndësishme për ti kthyer funksionale, këto objekte, pasi në shumë raste janë të dëmtuara dhe në disa të tjera mungojnë dhe mbylljet janë realizuar me materiale rrethore.

Zërat kryesore të ndërhyrjes, për ti transformuar këto objekte në të banueshme, janë :

- Mbulesa
- Zëvendësimi i dyerve
- Riparimi i tavaneve
- Suvatimi dhe lyerja e muraturës së brendshme
- Suvatimi dhe lyerja e muraturës së jashtme dhe të brendshme
- Patinime dhe lyerje
- Realizimi i muratures me tulla te plota sipas projektit
- Hidroizolim i tarraces
- Shtrese me pllaka granili

Totali i përfituesve përfshin 5 familje.

Konceptoi : Eneida Hoxha
Aldi Hoxha
Lyter Toro

